

**STRATEGJITË E REZISTENCËS DHE KUNDËRSHTIMIT TË
PUSHTETIT SERB NË KOSOVË NË VITET 1989-1997 SIPAS SHTYPIT
TË KOHËS**

**TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË HISTORI E KOHËS SË RE**

NGA

BEATRIS RAMSHA



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË**

QERSHOR, 2022

EKSPOZE E TEMËS

Mentor:

Prof. Asoc. Selim Bezeraj

Kandidati:

Beatris Ramsha

Kjo temë masteri me titull “*Strategjitë e Rezistencës dhe kundërshtimit të pushtetit serb në Kosovë në vitet 1989-1997 sipas shtypit të kohës*”, paraqet një kontribut modest në kuadër të historiografisë shqiptare, duke e duke e ditur se kjo problematikë nuk është trajtuar aq shumë nga këndvështrimi i shtypit të kohës, që në atë kohë e kishte shumë të vështirë të bënte edhe botimin e gazetave për shkak të presionit të madh që i bënte qeveria serbe.

Pikërisht strategjitë e rezistencës dhe kundërshtimit të pushtetit serb në Kosovë gjatë viteve 1989-1997 sipas mënyrës se si i kanë shfaqur shtypi i asaj kohe, kjo është ajo që shfaqet në këtë punim, i cili është i ndarë në tre kapituj.

Metodat që kam përdorur për realizmin e kësaj teme janë: Metoda e analizës, duke analizuar shtypin e kohës të viteve 1989-1997, pastaj metodën përshkruese duke përshkruar për ngjarjet që kishte shkruar shtypi i asaj kohe, poashtu kam përdorur edhe metodën e krahasimit, duke krahasur ngjarje të caktuara sesi ishin paraqitur në gazetatat e asaj kohe.

Në hyrje të këtij punimi kam trajtuar për ngjarjet e viteve të 80-ta të shekullit të kaluar në Kosovë. Këtu trajtohet për memorandumun e famshëm të Akademisë së Shkencave të Serbisë, të botuar në vitin 1986, trajtohet edhe për veprën e Dimitrije Bogoviqit me titull “*Historia e Kosovës*”, trajtohet poashtu politika hegjemoniste dhe centraliste e Serbisë gjatë viteve të 80-ta, më pastaj përmendet edhe vizita e Millosheviqit në Kosovë, pastaj përmenden edhe disa konstatime të studuesve të huaj për nacionalizmin e Millosheviqit, flitet poashtu edhe për procesin e eliminimit të autonomisë së Kosovës.

Pas hyrjes vijon me kapitujt: “*I. Strategjitë jo të dhunshme për kundërshtimin e pushtetit serb në Kosovë në vitet 1989-1997,*” “*II. Strategjia paqësore e rezistencës dhe e*

kundërshtimit të pushtetit serb në Kosovë në vitet 1989-1997” dhe “III. “Strategjitë ushtrake të rezistencës dhe kundërshtimit të pushtetit serb në Kosovë në vitet 1989-1997.”

Në kapitullin e parë i cili titullohet: *“Strategjitë jo të dhunshme për kundërshtimin e pushtetit serb në Kosovë në vitet 1989-1997”*, do të trajtohet fillimisht greva e minatorëve të Trepçës e vitit 1989, se si ishte trajtuar ajo në shtypin e asaj kohe, por përveç kësaj do të trajtohet edhe disa nga tubimet e fillim vitit 1989 si solidarizim për grevat që bënë minatorët e Trepçës. Pastaj vazhdohet me trajtimin e demonstratave të shqiptarëve të Kosovës brenda dhe jashtë vendit se si i ka shfaqur shtypi i saj kohe këto demonstrata. Më pastaj vazhdohet me rezistencën në fushën e arsimit si një nga strategjitë kryesore të rezistencës në vitet 1990-1994, ku do tregohet se si e organizuan arsimin shqiptarët e Kosovës sipas asaj se çfarë kishte shkruajtur shtypi i asaj kohe. Më pastaj vazhdohet me protestat e studentëve të Universitetit të Prishtinës si ato të vitit 1991 dhe ato kryesoret të vitit 1997 se çfarë rëndësie i jepte shtypi i kohës këtyre protestave. Dhe në fund të këtij kapitulli flitet edhe për grevën e urisë nga Adem Demaçi kundër pushtimit të Rilindjes, si e shfaqën këtë grevë gazetatat e kohës.

Në kapitullin e dytë i cili titullohet: *“Strategjia paqësore e rezistencës dhe kundërshtimit të pushtetit serb në Kosovë në vitet 1989-1997”*, ku trajtohet për kundërshtimet për ndryshimet kushtetuese në Kosovë në vitet 1989-1990, ku trajtohen një sërë ngjarjesh të rëndësishme për popullin e Kosovës si Deklarata e Pavarësisë e 2 korrikut 1990 dhe Kushtetuta e Kaçanikut e 7 shtatorit të po atij viti në atë se si i shihte shtypi i asaj kohe këto ngjarje të rëndësishme për popullin e Kosovës. Dhe pastaj do të trajtohet edhe për rezistencën politike në vitet 1991-1997, në atë se cili ishin strategjitë kryesore për kundërshtimin e pushtetit serb në Kosovë nga partitë politike që e kishin në program strategjitë paqësore të rezistencës, për të shmangur një luftë të armatosur, se si i shfaqte shtypi i kohës këto strategji, pastaj për të gjitha takimet e politikanëve të Kosovës që i mbajtën në shtetet evropiane dhe në shtetet e tjera të botës, çfarë peshe i jepnin këtyre takimeve gazetatat e kohës e shumë gjëra të tjera që shfaqen në këtë kapitull të dytë të kësaj teme.

Në kapitullin e tretë me titull *“Strategjitë ushtarake të rezistencës dhe kundërshtimit të pushtetit serb në Kosovë në vitet 1989-1997”*, trajtohet për Formimin e UÇK-së në vitin 1989, dhe vazhdohet pastaj me sulmet e para të kësaj ushtrie kundër policisë serbe. Më pastaj

vazhdohet me programet që kishin për çështjen e Kosovës Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës dhe Lëvizja Popullore e Kosovës dhe në fund të këtij kapitulli flitet për disa nga strategjitë ushtrake që kishin shkruar shtypi i kohës në vitin 1997.

Në fund të punimit, si zakonisht janë dhënë edhe konkluzionet e ndryshme ndër të cilat i veçojmë:

Lëvizja kosovare e rezistencës joviolente u lind në matricën e ekskulzimizmave entik dhe fragmentarizmit të Jugosllavisë. Sado që ajo zgjodhi metodat e joviolencës, ajo nuk ishte pacifiste me termin strikt të fjalës. Ajo kishte të bëjë me çlirim dhe ishte lëvizje për ngritjen e shtetit. Situatat e tilla zakonisht përfundojnë në kryengritje dhe në konflikte të armatosura. Në fund, Kosova nuk mund t'i shmangej kryengritjes për çlirim dhe luftës.

1 tetori i vitit 1997 do të mbetet një nga datat më të rëndësishme në historinë e re të Kosovës. Shumë historian e kanë quajtur datë e kthesës së madhe duke pasur parasysh ndikimin që pati organizimi i protestës së Lëvizjes Studentore në Prishtinë, përfaqësuar nga një grup i studentëve të cilët brenda një kohe të shkurtër, në takime të drejtëpërdrejta me ta në qytete të ndryshme të Kosovës, arritën ta sensibilizonin opinionin vendor, me pas edhe atë ndërkombëtar se Kosova kishte nevojë për një organizim të protestës, e cila pati jehonë të madh botëror në të gjitha mediat e botës.

Pas lindjes së pacifizmit, rruga e luftës për të parën herë në formë të organizuar u paraqit në vitin 1993. Kjo rrugë doli në skenë në të njëjtën me dy forma të veprimit atë të UÇK-së dhe atë të LKÇK-së, që dallonin njëra me tjetrën. Njëra nga rrymat e luftës predikonte sulmin e menjëhershëm mbi fortesë, pa marrë parasysh orientimin e masave të gjera, pa marrë parasysh organizimin e vetë bartësve të luftës. Ndërsa rryma tjetër, duke cilësuar faktorin popull faktor kryesor dhe vendosës deklaronte se fortesa duhet medoemos të sulmohej, por më parë të organizohej populli dhe ta rrethonte në mënyrë të rregullt fortesën e armikut. Që të dy rrymat faktorin popull e quanin vendimtar por vetëm se ndryshonte qëndrimi në lidhje me mënyrën e organizimit të tij.